

PROCESVERBAL nr.1 – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rikonstrukcion I ambjenteve te ruajtjes se Serverit.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi 45210000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: **19,994,736.00 (Nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh**

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit i jemi referuar 34-35 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në bazë të përcaktimeve të nenit 12-13 dhe 76 të VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Ne seksionin 4 pika 4.4 te DST-ve “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Grupi i ngritur per hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim gjykoi që vlerësimi të bëhet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto **X**.

Si me poshte :

- | | |
|--|----------|
| • Çmimi | pikët 50 |
| • Propozimin Teknik (Cilësia - karakteristikat, Parametrat) | pikët 30 |
| • Organizimi, Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar | pikët 10 |
| • Afati, Koha e realizimit te projektit | pikët 10 |

Argumentim: Bazuar në pikën 2, neni 45 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar 2. *Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë koston gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

Bazuar në pikën 4, neni 45 të vkm VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës;

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Pika Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

1. Çmimi [50] pikë Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij. Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet $Pmaxk1$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet 7 $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Propozimin Teknik (Cilësia - karakteristikat, Parametrat) 20% pikët 0-20

AK ka përcaktuar kërkesat minimale që do të duhet të kënen. OE do të duhet të paraqesin propozimin nga administratori i shoqërisë për pajisjet teknike që disponojnë për realizimin e kontratës duke përcaktuar në deklaratë llojin dhe specifikimet teknike.

3. Organizimi, Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar . 10% pikët 10

Ky kriter është vendosur duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektit të procedurës... AK ka kërkuar një numër stafi të caktuar për marrjen e këtij shërbimi në të njëjtën kohë dhe më cilësi. Në bazë të kualifikimeve të stafit do të jetë dhënë marrja e pikëve.

4. Afati, Koha e realizimit të projektit 10% pikët 10

Ky kriter është vendosur si pjesë e propozimit teknik të kërkuar. OE do të paraqesin propozim teknik për objektin e kërkuar. AK ka kërkuar që nga momenti i lidhjes së kontratës realizimi duhet të përfundojë brenda 60 ditë pune. Në propozimin teknik ka rendesi koha e instalimit , për të

vilen AK ka vlersuar se sa me vogël te jete koha e realizimit aq me shume pike do te marr OE.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullavetë Prokurimit Publik”, të ndryshuar **’SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME Durrës SH.A’** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar . Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit (**shtojca 7**).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, të ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së parashikuar të kontratës që po prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar prej jo më të vogël se 50% e fondit limit është përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”..

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023 dhe 2024** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për Kontrata të mëparshme të ngjashme të suksesshme të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Këto kontrata duhet të jenë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, ose/dhe faturave tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore¹, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore² dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të*

¹ Shtuar me VKM 498/2024

² Shtuar me VKM 498/2024

madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektivit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë certifikimet ISO si me poshte:

- a.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente.
- b.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit **ISO 45001** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, ose ekuivalente.
- c.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardit **EN ISO 20000-1:2018** - Certifikimi i sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (Projektim, implementim, mirëmbajtje, asistencë dhe suport teknik i sistemeve të teknologjisë së informacionit), ose ekuivalente.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

³ Shtuar me VKM 498/2024

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”.

Kërkesa për Standardin ISO 9001:2015 (Për sistemin e menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente. Certifikata e standardit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi të kontratës objekt prokurimi, sipas standardeve ndërkombëtare.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë, siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik, proceset e punës së tij, ti bazojë në standarte botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, dhe efikasitet të shërbimeve të ofruara.

Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

Kërkesa për Standardin ISO 45001 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të

realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Kërkesa për standardin EN ISO 20000-1:2018 - Certifikimi i sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (Projektim, implementim, mirëmbajtje, asistencë dhe suport teknik i sistemeve të teknologjisë së informacionit), ose ekuivalente.

Certifikimi i sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit : është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, Certifikimi i sistemit për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, në projektim, implementim, mirëmbajtje, asistencë dhe suport teknik i sistemeve të teknologjisë së informacionit. Tregtim dhe furnizim me shumicë e pakicë, instalim, mirëmbajtje dhe asistencë teknike për software dhe hardware. Projektim, instalim, servise dhe mirëmbajtje e të gjitha llojeve të rrjeteve e sistemeve kompjuterike, IT, elektronike, , të sigurisë, radio-komunikimit dhe impiante teknologjike speciale. Shërbime të komunikimit dhe marketingut online, menaxhime të projekteve dhe trajnime për teknologjinë e informacionit.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar dhe respektivisht në përbërje të stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë:

- a. 2 (dy) Inxhinier Elektrik/Elektronik (regjistruar ne listepagesat e kompanise).
- b. 1 (nje) punonjes IT ose i fushave te ngjashme (regjistruar ne listepagesat e kompanise).
- c. Minimalisht 2 (dy) specialiste te certifikuar per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve dhe instalimeve elektrike.
- d. 1 (nje) drejtues teknik te licensuar ne projektim te rrjetave elektrike dhe te internetit Kategoria 4 per mbikqyrjen dhe mbarevajtjen dhe ecurise se sistemit te kerkuar.

Për të vërtetuar kualifikimet dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (certifikimin/diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.

- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për 2 (dy) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Argumentimi 2.3.3: Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40, pika 5), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe projektit.

- **Inxhinier elektrik/elektronik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve/instalimeve elektrike dhe sistemit të kondicionimit në RACK , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës IT** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve kompjuterike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Minimalisht 2 (dy) specialiste të certifikuar për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike**, për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **1 (një) drejtues teknik të licensuar në projektim të rrjetave elektrike dhe të internetit Kategoria 4 për mbikqyrjen dhe mbarevajtjen dhe ecurisë së sistemit të kerkuar**, është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të networkut dhe RACK , sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kërkesa për të vërtetuar kualifikimet dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për listëpagesat është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga shoqëria projektuese. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet jete i pajisur me License Projektimi në kategorite e mëposhteme:

Kategoria NS-13A Impjante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Kategoria NS- 14A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht :

dhe telekomunikacioni : “ Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme ”

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet zërave të parashikuara në preventivin e punimeve e networkut dhe sistemet CCTV , dhe sipas parashikimit të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, të sipërcituar, për këtë kategori. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”.

Licenca për punimet e përgjithshme të ndërtimit është kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për çdo kategori licence.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S- 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV** ”: Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet zërave të parashikuara në preventivin e punimeve elektrike , dhe sipas parashikimit të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, të sipërcituar, për këtë kategori. Përcaktimi i nivelit “A” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”.

Licencat për punimet speciale të ndërtimit është kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për çdo kategori licence.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim nga Prodhuuesi ose Distributori i autorizuar per zgjidhjen teknologjike te ofruar, lëshuar për operatorin ekonomik ofertues,i cili duhet të përmbajë dhënien e të drejtave për furnizimin e produkteve objekt i prokurimit.

Në rastin e dokumenteve të lëshuara nga Distributor i Autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë detyrimisht edhe aktin e caktimit të distributorit nga prodhuesi përkatës.

Autorizimi duhet në formën origjinal ose kopje e njehësuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar. Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë. Në rast se Autorizimi nuk i përmban këto të dhëna dokumenti do të konsiderohet i pavlefshëm për qëllim kualifikimi.

Argumentimi 2.3.5: *Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm që na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 dhe 8, të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen.

Argumentimi *Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike, me qëllim verifikimin e plotësimin të specifikimeve teknike.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.